



UNIVERSITETI I TETOVËS

UNIVERSITY OF TETOVA - УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

UT Rectorate - Ilinden nn. 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

UT - Fakulteti Ekonomik - Република e Македонија сè Verhet
УТ - Економски Факултет - Република Северна Македонија
Nr.-Br. 14 - 644/1
28.09 2020 viti/rod.
Tetovë ТЕТОВО

**FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI: FINANCË
CIKLI I TRETË I STUDIMEVE – STUDIMET E DOKTORATURËS**

**DREJTUAR:
KËSHILLIT MËSIMOR SHKENCOR
TË FAKULTETIT EKONOMIK
CIKLI I -III- të I STUDIMEVE**

**RAPORT
PËR VLERËSIMIN E PUNIMIT TË DOKTORATURËS
TË KANDIDATES -MrSc. ENKELEDA LULAJ**

Në bazë të vendimit nr. 14-392/1 të datës 18.06.2020 të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Ekonomik, për formimin e komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoratës, si dhe në bazë të nenit 51 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve - studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës, komisioni në përbërje:

- 1. Prof. dr. Etem Iseni – kryetar**
- 2. Prof. dr. Seadin Xhaferi – anëtar**
- 3. Prof. dr. Merale Fetahi - Vehapi – anëtare**
- 4. Prof. dr. Izet Zeqiri – anëtar**
- 5. Prof. dr. Hamit Aliu – mentor**

Komisioni pasë vlerësimin të doktoratës: me titull **“Parametrat e reformimit në buxhetin publik (Transparenca dhe performanca në qeverisje)”**, të kandidatës **Mr.Sc. Enkeleda Lulaj**, paraqet këtë:

RAPORT PËR VLERËSIMIN E PUNIMIT TË DOKTORATURËS

Lënda e hulumtimit:

Rëndësia e financave dhe kontabilitetit publik më theks të veçantë buxheti publik si një fushë e rëndësishme dhe specifike ,çdo ditë e më shumë po bëhet e domosdoshme për rritje të transparencës dhe llogaridhënies buxhetore , të dy këto parametra që matin performancën gjatë qeverisjes dhe stabilitetin ekonomik të vendit. Rregullat dhe procedurat gjatë planifikimit më të cilat aprovohet dhe zbatohet buxheti duhet të kenë efekt pozitiv financiar . Buxheti i shtetit si dokument kryesor shtetëror duhet të bazohet në përlllogaritje të situatave fiskale dhe duhet të mos jetë e nevojshme të rishikohet (ri aprovohet) gjatë vitit të zbatimit të tij .Me të drejtë kandidatja thot se buxheti po bëhet gjithnjë e më shumë mjete kryesor për manaxhimin ekonomik të vendit në tërësi. Pra, buxheti është pjesërisht politik ,pjesërisht ekonomik ,pjesërisht i kontabilizuar ,pjesërisht administrativ . Si një dokument politik ,ai ndan burimet e pakta të një shoqërie midis interesave të shumta konfliktuoze dhe konkurruese. Në punimin e disertacionit kandidatja e shikonë nga prizma i një dokumenti ekonomik dhe fiskal, buxheti shërben si instrument primar për vlerësimin e rishpërndarjes së të ardhurave në mënyrë ligjore ,duke nxitur rritjen dhe zhvillimin e saj ,duke luftuar inflacionin , duke nxitur punësimin e plotë dhe duke ruajtur stabilitetin ekonomik. Nga aspekti kontabël, buxheti siguron një kufi mbi shpenzimet qeveritare , duke iu përmbajtur kufijve buxhetor të aprovuar nga qeveria ,dhe së fundmi buxheti si një dokument manaxherial dhe administrativ përcakton mënyrat dhe mjetet më anë të cilave ofrohen shërbime publike dhe përcaktohen kriteret më anë të cilave ato monitorohen ,matën dhe vlerësohen.

Sipas kandidates të punimit, duhet patur parasyshë se Kosova është një vend në tranzicion, rëndësia për transparencë dhe performancë gjatë procesit buxhetor nga planifikimi e deri tek zbatimi i tij ndikon në rritje dhe përmirësim të zhvillimit ekonomik . Kureshtja që të shoh nga afër transparencën dhe performancën në buxhetin publik gjatë

qeverisjes në nivel qendror dhe lokal e bëri kandidaten që ti qaset këtij projekti hulumtues së cilët kanë qenë dhe janë parametrat e reformave financiare duke ndikuar në rezultatet pozitive apo negative nga viti në vit .

Lidhur më përdorimin e buxhetit ekzistojnë përdorues të ndryshëm në nivele të ndryshëm të qeverisë dhe secili nga përdoruesit e buxhetit ka përgjegjësitë e përgatitjes dhe shfrytëzimit të buxhetit. Gjatë përgatitjes dhe shfrytëzimit të buxhetit ekzistojnë lloje të ndryshme të problemeve që hasen .Në rastin e nivelit Komunal probleme tek drejtoritë si përdorues të buxhetit, si dhe niveli qendror apo Ministria e Financave si planifikuese për mjete buxhetore dhe shpërndarjen e tyre. Në shumicën e përdoruesve të buxhetit vërehen mangësi në organizimin e planeve të tyre sipas objektivave primare të dy niveleve në lidhje me planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit .

Pra, qëllimi i këtij punimi të disertacionit është të vlerësojë ndikimin e parametrave të reformimit financiar gjatë procesit të buxhetimit , me theks të veçantë transparencën dhe performancën buxhetore në qeverisje qendrore dhe komunale duke pasur parasysh disa nga specifikat apo qëllimet të cilat duhet të hulumtohen .Secili qëllim ngërthen në vete disa pyetje të parashtruara të cilat do të hulumtohen në buxhetin e Kosovës duke u bazuar në vitet e kaluara si dhe në gjetjet e vendeve tjera:

1. Cilat janë karakteristikat e qeverisjes buxhetore në të dy nivelet

Nga këndvështrimet e politikës publike dhe procesit buxhetor, drejtoritë e një niveli lokal apo qendror a dallojnë për nga karakteristikat e qeverisjes së drejtorive nga një Komunë tek tjetra, apo dallimet në mes të nivelit qendror dhe lokal. Kjo do të thotë që qytetarët e çdo vendi do të përfitojnë nga një sektor publik i cili i nënshtrohet të njëjtave rregulla dhe procedura të njëjta që zbatohen në sektorët tjerë. Që proceset e buxhetimit dhe shfrytëzimit të jenë efektive, ato duhet të bazohen në plane dhe program të argumentuar dhe të përpunuar, sepse qeveritë që kanë rregulla fiskale efektive kanë disiplinë më të fortë buxhetore.

2. Cili është efekti i transparencës buxhetore në rritje të performancës gjatë qeverisjes

Përformanca dhe transparenca e dobët shpesh gjendet në lidhjet e dobëta midis bërjes së politikave, planifikimit dhe buxhetimit. Në një nivel, hartimi i politikave dhe planifikimi nuk janë të kufizuara nga ajo që një vend do të jetë në gjendje të përballojë gjatë një periudhe afat mesme.Në një nivel tjetër, hartimi i politikave dhe planifikimi nuk janë të

informuara në mënyrë të mjaftueshme nga implikimet e tyre buxhetore dhe nga ndikimet e tyre të mundshme në komunitetin e gjerë. Pamjaftueshmëria e kufizimeve buxhetore ndaj vendimmarrësve gjatë planifikimit dhe fazave të formulimit të ciklit buxhetor çon në financimin joadekuat të operacioneve, kontrollin e dobët të shpenzimeve, dhe paparashikueshmërinë në rrjedhën e burimeve të buxhetuara qeverive përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve. Duke pasur parasysh rastin e sistemit të ndarjeve buxhetore në Kosovë, është shikuar saktësisht nga ana e kandidatës se cilat burime janë caktuar për të cilat organet publike dhe se paratë janë përdorur në përputhje me prioritetet e synuara.

3. A ekziston harmonizimi dhe koordinimi gjatë ciklit buxhetor

Është e rëndësishme se gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit ciklet buxhetore në çdo nivel duhet të jenë të harmonizuara dhe të koordinuara. Kjo është gjithashtu arsyeja pse një kuptim themelor i procedurave dhe afateve kohore në përgatitjen e buxhetit në nivel qendror është i rëndësishëm për të kuptuar procesin e buxhetit në nivel lokal. Për më tepër, duhet buxhetet përcaktojnë "përdorimin" dhe "qëllimin". Qëllimi i një buxheti lidhet me rezultatet e synuara që do të thotë se të gjithë zërat e buxhetit duhet të janë të lidhura me aktivitetet e planifikuara në të cilat shpenzohen fondet publike dhe qëllimin e shpenzimeve.

4. A bëhet financimi buxhetor sipas prioriteteve

Gjetja e burimeve adekuate për financimin e prioriteteve qendrore apo lokale është bërë një sfidë e vërtetë për vendet në mbarë botën jo vetëm në Kosovë. Kjo sfidë, sipas kandidatës është përkeqësuar në vendet në zhvillim që nuk kanë fonde të mjaftueshme për të plotësuar nevojat dhe kërkesat bazë të popullsisë së tyre. Presionet e rritura për burimet buxhetore kanë bërë që politikë bërësit, të kërkojnë mënyra më efikase për të ofruar shërbime komunale. Rritja e burimeve publike ose më saktë, zgjerimi i "hapësirës fiskale" për nivelet komunale nuk ka domosdoshmërisht nevojë të vijë nga të ardhura më të mëdha tatimore ose nga buxhete më të mëdha. Shpesh herë, nuk është shuma e shpenzimeve për kryerjen e shërbimeve, por efektiviteti me të cilin përdoren ato fonde, ka rëndësi më të madhe. Përmirësimet e efektivitetit dhe efikasitetit në sektorin e publik, madje edhe në sasi të vogla, mund të japin kursime të konsiderueshme kostoje dhe madje të lehtësojnë zgjerimin e shërbimeve për komunitetin. Minimizimi i mbetjeve, korrupsionit dhe formave të tjera të jo efektiviteti dhe paefektshmëria ndikojnë në rritjen

e përformancës dhe transparencës me mjete buxhetore. Përveç kësaj, për të përdorur efektivisht burimet dhe për të kuptuar se si janë shfrytëzuar fondet publike, dhe si ato kontribuojnë në politikat e qeverisë, është e rëndësishme të monitorohen rezultatet e shpenzimeve sipas sistemeve qeveritare të monitorimit dhe vlerësimit. Një tipar i përbashkët i këtyre sistemeve përfshin Ministrinë e Financave duke mbajtur agjencitë shpenzuese në kontroll duke kërkuar raporte mbi përformancën financiare. Kjo e fundit gjithashtu referohet si rezultat i shpenzimeve qeveritare dhe mund të matet në nivelet e rezultateve dhe ndikimeve, që përfshin përcaktimin e treguesve të përformancës.

Qëllimi i hulumtimit:

Qëllimi dhe arsyeja e disertacionit lidhur me parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik, transparenca dhe përformanca në qeverisje është shumë aktuale dhe ky aktualitet ka rëndësi të posaçme në Kosovë dhe më gjerë. Nga ky aspekt është qasja e kandidatës ndaj punimit të doktoratës që të shoh nga afër dhe të vërtetoj, nëse ka reforma financiare, transparenca buxhetore dhe përformancë gjatë qeverisjes në shtetin e Kosovës si një shtet i ri. Cilat kanë qenë reformat financiare ndër vite, në cilët zëra financiar dhe buxhetor ka transparenca dhe përformancë më të madhe apo më të vogël, si dhe sa është në gjendje ti realizojë këta dy tregues esencial për zhvillim ekonomik dhe stabilitet financiar. Rëndësia e financave, kontabilitetit publik, raportimit financiar më theks të veçantë në buxhetin publik si një fushë e rëndësishme dhe specifike çdo ditë e më shumë po bëhet e domosdoshme për rritje të mirëqenies së popullsisë dhe vendit në tërësi. Një proces buxhetor i mirë, karakterizohet më transparenca, integritetin, sinqeritetin, pjesëmarrjen, përgjegjësinë, përformancën, llogaridhënien dhe qasjen strategjike për planifikimin buxhetor dhe arritjen e objektivave buxhetore të shtetit. Për gjetjen e burimeve adekuate në financimin e projekteve dhe realizimin e kërkesave të popullsisë në të dy nivelet e qeverisjes (qendrore dhe lokale), duhet që hartuesit e politikave buxhetore të kërkojnë mënyra më efikase për të ofruar shërbime dhe për të plotësuar nevojat e shoqërisë në tërësi si dhe alokimin sa më të saktë të burimeve, për të rritur transparenca në paratë publike dhe përformancën e organeve qeverisëse.

Ky disertacion, përveç analizimit dhe elaborimit në aspektin teorik të buxhetit publik, të teorive dhe praktikave buxhetore të vendeve tjera si model për Kosovën, si mjet i

rëndësishëm për vendimmarrje dhe proces më të mirë buxhetor, ka dhe pjesën praktike të realizuar përmes metodologjive më të mira. Pjesa e parë praktike apo analiza krahasuese është analizuar përmes pyetjes kërkimore për periudhën dhjetë vjeçare (2007-2017) duke u bazuar në të dhënat nga raportet e auditimit financiarë dhe buxhetorë tek të dy nivelet e qeverisjes (qendror dhe lokal- Komunitat) për secilin vit, për të shikuar se cilat kanë qenë reformat financiare që kanë ndikuar në rritje të performancës dhe transparencës buxhetore gjatë qeverisjes. Ndërsa pjesa e dytë praktike apo metoda cilësore, është analizuar përmes realizimit të intervistës (pyetësorit) tek të dy nivelet e qeverisjes më zyrtarët e buxhetit, duke bërë përpunimin e të dhënave më anë të programeve SPSS dhe R përmes modeleve ekonometrike dhe statistikore dhe të gjitha testeve që i përshtaten modelit, për të matur saktë transparencën dhe performancën buxhetore si dhe përgjegjësitë e niveleve qeverisëse gjatë procesit buxhetor, të ardhurat dhe shpenzimet, raportimin financiar, për programet e ofruara, efikasitet dhe efektivitetin në qeverisje etj., duke vërtetuar hipotezën kryesore dhe ato ndihmëse. Në fund paraqiten të gjitha rekomandimet të cilat duhet të merren parasysh në mënyrë që të shkojmë drejtë një procesi buxhetor të mirë qeverisur.

Pritjet shkencore nga hulumtimi:

Risia e këtij punimi është gjetja e rezultateve dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik gjatë transparencës dhe performancës buxhetore, duke i theksuar më gjerësisht në tërë punimin dhe në konkluzionet e dhëna.

Buxheti po bëhet gjithnjë e më shumë mjete kryesor për menaxhimin ekonomik të vendit në tërësi. Pra, buxheti është pjesërisht politik, pjesërisht ekonomik, pjesërisht kontabël, pjesërisht administrativ apo menaxherial. Si një dokument politik, ai ndan burimet e pakta të një shoqërie midis interesave të shumta konfliktuoze dhe konkurruese, nga prizmi i një dokumenti ekonomik dhe fiskal, buxheti shërben si instrument primar për vlerësimin e rishpërndarjes së të ardhurave në mënyrë ligjore duke nxitur rritjen dhe zhvillimin e saj, duke luftuar inflacionin, duke nxitur punësimin e plotë dhe duke ruajtur stabilitetin ekonomik. Nga aspekti kontabël, buxheti siguron një kufi mbi shpenzimet

qeveritare, duke iu përmbajtur kufijve buxhetor të aprovuar nga qeveria, dhe së fundi buxheti si një dokument menaxherial dhe administrativ përcakton mënyrat, mjetet dhe kriteret përmes të cilave ofrohen shërbime publike, monitorohen, matën dhe vlerësohen.

Duke pasur parasysh se buxheti shtetëror po behët gjithnjë e më shumë mjet kryesor për menaxhimin ekonomik të vendit në tërësi. Dobishmëria e rezultateve apo disa nga pritjet shkencore që do të dalin nga ky hulumtim janë:

- ✓ Buxheti duhet të jetë i lidhur ngushtë më përgatitjen dhe paraqitjen e informacioneve të besueshme për të legjitimuar llogaridhënien apo transparencën, dhe për të lejuar vlerësimin e saktë të qeverive lokale dhe qendrore duke pasur parasysh dhe shpërblimet për suksesin e arritur tek të dy nivelet,
- ✓ Buxheti duhet të ndikojë në mirëqenien e shoqërisë në përgjithësi dhe jo vetëm të partisë në pushtet, pra ka të bëjë më përmbushjen e nevojave kontradiktore dhe shpërndarjeve të burimeve në mes të nevojave X dhe Y përmes përshtatjeve shtesë gjatë alokimit të buxhetit,
- ✓ Buxheti duhet të jetë një dokument që përmban një plan paraprakisht të miratuar të ardhurave dhe shpenzimeve publike,
- ✓ Institucionet qeveritare qoftë qendrore apo lokale duhet që të shqyrtojnë në mënyrë aktive buxhetin si tërësi për çdo vit, dhe jo të bazohen në buxhetin e vitit të kaluar duke bërë ndryshim për gamë të ngushtë rritjeje apo zvogëlimi,
- ✓ Lidhjen e saktë në mes të planifikimit dhe shfrytëzimit të buxhetit,
- ✓ Kontroll institucional gjatë procesit buxhetor për secilin përdorues buxhetor,
- ✓ Raportimi për buxhetin e realizuar në programet që janë planifikuar në fillim,
- ✓ Transparenca në dokumentet publike në nivelin lokal-komunal,
- ✓ Raportim dhe llogaridhënie për dëmtimin e të hyrave buxhetore nga evazioni apo ekonomia joformale,
- ✓ Përkufizim i prioriteteve buxhetore që imponojnë zgjedhje të vështira në kushte të mungesës së resurseve,
- ✓ Efekt i një politike kontabël të mirëfillte dhe raportimit financiar etj.

Punimi i disertacionit sipas vlerësimeve të mija do të jetë ndihmesë për politikën buxhetore në shtetin e Kosovës dhe më gjerë, si dhe bazë referuese për hulumtuesit e

ardhshëm vendor dhe të huaj, për parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik lidhur më transparencën dhe performancën buxhetore tek të dy nivelet e qeverisjes. Duke pasur parasysh se Kosova është një vend në tranzicion, rëndësia për transparencë dhe performancë gjatë procesit buxhetor nga planifikimi e deri tek zbatimi i tij ndikon në rritje dhe përmirësim të zhvillimit ekonomik. Kureshtja që të shoh nga afër transparencën dhe performancën në buxhetin publik gjatë qeverisjes në nivel qendror dhe lokal, më bëri që ti qasem këtij projekti hulumtues për të parë së cilët kanë qenë dhe janë parametrat e reformave financiare duke ndikuar në rezultatet pozitive apo negative nga viti në vit .

Fusha shkencore e hulumtimit:

Për buxhetin flitet qysh nga kohërat e ekzistimit të njeriut e deri më tani , në secilën etapë rëndësia dhe roli i buxhetit dhe parasë publike ka ndikuar në reforma financiare qoftë rritje apo ulje të zhvillimit ekonomik dhe stabilitet financiar. Pra, gjatë interesimit për buxhetin publik nga hartuesit e politikave buxhetore qoftë në nivel qendror apo lokal, apo edhe nga qytetarët e vendit , ka lindur nevoja që të kemi njohuri rreth aspektit teorik dhe thelbin e teorive të cilat të cilat ndihmojnë për tu marr më marrë me problemet gjatë procesit buxhetor dhe gjetjen e rezultateve sa më të mira gjatë praktikimit të buxhetit shtetëror. Rreth parametrave për reformat financiare gjatë qeverisjes buxhetore kanë dhënë kontribut të rëndësishëm shumë teoricien të cilët janë detajisht të cekur tek rishikimi i literaturës nga ana e kandidatës. Disa nga ata si, Bartle, Key, Hindereth , Smithies , Wildawsky , Mosher , Schick , Hyde , Stourm ,Bastable ,Crown, Dayton, Miller , Meltzer , Persson dhe Tabellini et.

Fillimisht, kandidatja ka bërë definimi i problemit tek hulumtimit dhe në bazë të tij janë ngritur Hipotezat, tri hipoteza kryesore dhe nën hipotezat që përfshijnë variablat e varura dhe pavarurua. Të dhënat janë analizuar duke përdorur programet SPSS,R . Vërtetimi i hipotezave është bërë përmes metodave statistikore dhe modeleve ekonometrike duke përdorur testet që përkojnë me hulumtimin, disa nga testet si, (OLS, Licert Scale, T-test, Brunner-Munzel- Test mostra për transparencën dhe performancën buxhetore në komuna më popullsi më të vogël , Kendall's Tau coefficient mostra për transparencën dhe performancën buxhetore në komuna më popullsi më të madhe , Analiza e korrelacionit –

mostra për T dhe P buxhetore në me të niveleve qeverisës : Qendror-Komunal , Komuna-Komuna , Mann-Whitney test, mesatarja e T dhe P në nivelin Komuna, si dhe Modele tjera që kanë të bëjnë më vërtetimin e hipotezave të ngritura (Model GLM (Generalized linear model), Nonparametric regresion ,Model log ,Bootstrapping (statistics), Shkallet e lirisë dhe termi i gabimit, variancën buxhetore në mes të viteve etj.) .

Mostra është realizuar përmes pyetësorëve sipas OECD ,në nivelin lokal –Komunat , fillimisht kandidatja ka realizuar intervistën në Ministrin e financave dhe zyrtarë të tjerë të buxhetit në kuadër të Ministrisë , pas intervistës më disa ndërhyrje nga ana e MEF-it në pyetësor, është lejuar shpërndarja e pyetësorëve në nivelin lokal apo komunal tek departamenti i financave komunale. Pyetësori në shumicën e Komunave është dërguar tek kryetari i Komunës përmes tij tek drejtorët dhe zyrtarët buxhetor nëpërmes emali-plotësim online. Ndërsa në disa Komuna është dashur vizita në Komunë . Plotësimi është bërë në mënyrë shumë të saktë duke e vërtetuar dhe më dokumentacionin dhe raportet financiare .

Pyetësori është i ndarë në tri pjesë :

- 1.Sesioni i transparencës buxhetore -50 pyetje apo variabla sipas SL (shkallëve të Likertit);
- 2.Sesioni i performancës buxhetore – 50 pyetje apo variabla sipas SL (shkallëve të Likertit),
- 3.Sesioni i pyetjeve të kombinuara për reformat financiare ,të cilave është dashur tu përgjigjen më shkrime, se cilët kanë qenë parametrat e reformimit financiar, cilat janë marrëdhënien në mes të nivelit qendror dhe lokal etj.

Përveç plotësimit të pyetjeve më shkallë të Likertit sipas kandidatës, shumica e komunave kanë dhënë dhe përgjigje shtesë duke e bërë plotësimin e këtij pyetësorit mjaftë kredibil dhe të saktë .

Në punim janë përdorur dy metoda:

- 1.Metoda kualitative (cilësore) duke u bazuar në të dhënat të cilat janë publikuar në çdo vit (metoda krahasuese) në mes të viteve dhe të Nivelit Qendror dhe Lokal (Qeveria, Ministrinë dhe Komunat).

2. Metoda kuantitative (sasiore) duke u bazuar në të dhënat që do të grumbullohen nga anketa apo pyetësi në nivelin lokal dhe tek MEF për reformat financiare ,transparencën dhe performancën buxhetore ?

Gjetjet nga hulumtimi janë paraqitur në formë të tabelave dhe grafikëve për secilën variabël të studiuar duke dhënë rekomandimet të nevojshme për buxhetimin publik të cilat do ti ndihmojnë shtetit të Kosovës për analiza të mëtutjeshme në lëminë e financave dhe të kontabilitetit ,të raportimit financiar dhe të auditimit. Duke ia bashkangjitur të gjithë shtojcat për të gjithë modelet e realizuara ,gjithashtu dhe pyetësin . Gjithashtu do të jetë bazë referuese për analiza të mëtutjeshme nga analist, zyrtar buxhetor , hulumtues të tjerë qoftë vendor apo të huaj .

Rezultatet e hulumtimit:

Punimi i disertacionit të Doktoratës i titulluar me titull “Parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik (transparenca dhe performanca në qeverisje” nga kandidatja MSc. Enkeleda Lulaj, është material i hulumtuar dhe studiuar në mënyrë shumë komplekse të një problematike aktuale të buxhetit në aspektin e transparencës dhe performancës gjatë qeverisjes.

Rezultati hulumtues e këtij disertacioni është elaboruar analiza e të dhënave dhe rezultatet kërkimore apo metoda cilësore përmes modeleve ekonometrike dhe statistikore për nivelin qendror dhe lokal- komunat e Kosovës (pyetësi sipas SHL-ve). Në veçanti janë sqaruar temat si më poshtë:

- Transparenca dhe performanca në qeverisje buxhetore
- Analiza e statistikave përshkruese për transparencë, performancë dhe reforma financiare–buxhetore : Statistikat përshkruese për të anketuarit; Anova dhe Tukey test për të anketuarit
- Modeli i analizës së besueshmërisë për transparencë, performancë dhe reforma financiare;

- Analiza faktoriale dhe analiza e besueshmërisë së të dhënave në reformat financiare-buxhetore: Transparenca gjatë qeverisjes buxhetore: Roli i faktorëve në transparencë buxhetore si parametra të reformimit financiar, Planifikimi buxhetor (fillimi dhe përfundimi i vitit buxhetor); Faktori I – Planifikimi i buxhetit duke u bazuar në ligjshmëri ; Faktori II – Planifikimi i buxhetit në përputhje më afatet kohore; Faktori III – Planifikimi buxhetor duke u bazuar në kërkesa ; Pjesëmarrja e qytetarëve dhe organeve tjera gjatë procesit buxhetor ; Aprovimi i buxhetit; Zbatimi i buxhetit (efiçenca buxhetore); Faktori I – Zbatimi i buxhetit sipas LMFP; Faktori II – Efiçenca buxhetore; Përgatitja (përpilimi) e raporteve buxhetore për rritje të transparencës buxhetore; Faktori I – Përgatitja e raporteve financiare në dispozicion për publikun; Faktori I i nën faktori të parë – Përgatitja e raporteve fiskale dhe makroekonomike në dispozicion për publikun; Faktori II i nën faktori të parë – Transparenca në afate kohore për përpilim të raporteve buxhetore ; Faktori II – Transparenca në përgatitje të raporteve buxhetore për publikim; Publikimi i raporteve (dokumenteve financiare-buxhetore) për rritje të transparencës buxhetore; Faktori I- Transparenca e raporteve financiare-buxhetore të publikuara; Faktori II- Efiçenca në raporte financiare-buxhetore në dispozicion të publikut dhe organeve tjera; Kontrolli buxhetor ; Bashkëpunimi buxhetor; Faktori I- Qartësia në dokumente për bashkëpunim gjatë procesit buxhetor; Faktori II- Përgjegjësitë për bashkëpunim gjatë procesit buxhetor; Llogaridhënia dhe raportimi financiar në kërkesat dhe dokumentet buxhetore ; Faktori I – Llogaridhënia dhe raportimi financiar deri në publikim të raporteve financiare-buxhetore buxhetore ; Faktori II- Llogaridhënia dhe raportimi financiar pas publikimit të raporteve financiare-buxhetore; Faktori III- Kërkesat buxhetore në përputhje më planin strategjik dhe projektet primare të Komunës; Roli i faktorëve në performancë buxhetore; Performanca gjatë procesit buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim); Faktori I- Ndarja e drejtë buxhetore për rritje të performancës; Sfidat gjatë procesit buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim); Faktori I- Mungesa e përkushtimit gjatë procesit buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim); Faktori II- Mospërputhjet dhe mungesat gjatë procesit buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim); Faktori III- Mungesat e të dhënave-informacioneve të sakta gjatë procesit

buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim);Përmirësimi gjatë procesit buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim);Faktori I- Përdorimi transparent i buxhetit në përmirësim dhe rritje të përformancës buxhetore; Faktori II- Përmbushja e objektivave gjatë procesit buxhetor; Nën-faktori I i faktorit II - Reforma në përmbushje të objektivave buxhetore ;Përformanca në raporte financiare - buxhetore ;Faktori I - Rritja e përformancës në bazë të transparencës në raporte buxhetore; Bashkëpunimi gjatë procesit buxhetor Faktori I – Marrëveshjet dhe treguesit financiar për rritje të përformancës (kontrolli, stabiliteti politik ,përgjegjësia dhe llogaridhënia);Faktori II – Ekspertet për planifikim buxhetor dhe njësitë përgjegjëse për praktika të buxhetimit; Faktori III – Mosbashkëpunimi gjatë procesit buxhetor; Reformat financiare-buxhetore; Faktori I- Reforma në treguesit financiar ;Faktori II- Reforma në rregullat për ndarje buxhetore ;Faktori III- Reforma në ruajtjen e parasë publike ;Faktori IV- Reforma në shpërndarje të fondeve; Faktori V- Reforma për ndarje të drejtë të shpenzimeve; Centralizimi i procedurave buxhetore dhe kontrolli financiar;

- Modeli i regresionit të shumëfishtë për transparencë, përformancë dhe reforma financiare: Roli dhe ndikimi i regresionit të shumëfishtë në transparencën buxhetore ;Planifikimi i buxhetit; Aprovimi i buxhetit; Zbatimi i buxhetit; Përgatitja e raporteve financiare- buxhetore ;Publikimi i raporteve (dokumenteve) financiare-buxhetore; Bashkëpunimi buxhetor; Llogaridhënia dhe raportimi financiar në kërkesat dhe dokumentet buxhetore ;Kontrolli buxhetor ;Roli dhe ndikimi i regresionit të shumëfishtë në përformancën buxhetore ;Procesi buxhetor (planifikimi-aprovimi-zbatimi);Sfidat gjatë procesit buxhetor (planifikimi-aprovimi-zbatimi);Përmirësimi i përformancës buxhetore gjatë procesit buxhetor (planifikimi-aprovimi-zbatimi); Përformanca në raporte financiare buxhetore; Bashkëpunimi gjatë procesit buxhetor (planifikim-aprovim-zbatim) për rritje të përformancës buxhetore ;Reformat financiare- buxhetore ;Treguesit e përbashkët - Transparenca dhe Përformanca si parametra për reformat financiare dhe buxhetore; Transparenca gjatë procesit buxhetor në përmirësim dhe rritje të përformancës buxhetore;

- Përgjegjësitë buxhetore të niveleve qeverisëse: Testi i dy mostrave të varura për përgjegjësitë buxhetore të dy niveleve: Qendror dhe Komunal; Përgjegjësitë buxhetore të niveleve qeverisëse;
- Analiza e problemeve kryesore në përgatitjen e buxhetit në nivelin Komunal (38 Komuna) ;
- Analiza e problemeve kryesore gjatë përdorimit (shfrytëzimit) të buxhetit në nivelin Komunal (38 Komuna);
- Analiza e reformave më të rëndësishme në nivelin Komunal ;
- Analiza e parametrave të reformimit financiar në buxhetin publik për rritje të transparencës dhe performancës gjatë qeverisjes ;
- Rezultatet e përgjigjeve të pyetësorëve

Gjetjet kryesore janë bërë përmes modeleve ekonometrike dhe statistikore për nivelin qendror dhe lokal- komunat e Kosovës, duke i vërtetuar hipotezat tek kapitulli i katërt dhe pyetjen kërkimore tek kapitulli i tretë. Në veçanti janë sqaruar temat si më poshtë:

- ✓ Analiza buxhetore për periudhën 2007-2017
- ✓ Analiza për transparencën buxhetore
- ✓ Analiza për performancën buxhetore
- ✓ Analiza për përgjegjësitë buxhetore
- ✓ Analiza për parametrat e reformimit financiar – buxhetor
- ✓ Ndërlidhja e këtyre analizave

Duke pasur parasysh që në detaje janë sqaruar përmes tabelave, diagrameve dhe figurave të dalura nga programi SPSS dhe R, gjithë titujt më lartë të këtij kapitulli në këtë raport ipen vetëm në pika të shkurtra se çka përmban ky kapitull.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatës:

Në periudhën e kaluar kandidatëja MrSc. Enkeleda Lulaj në mënyrë aktive është përfshirë në hulumtimin dhe analizën e problemeve që janë të lidhura në mënyrë direkte ose indirekte me punimin e disertacionit në fjalë.

Gjatë periudhës së studimeve kandidatja ka marrë pjesë në disa konferenca tematike për problematikën në fjalë dhe në mënyrë aktive punon në hulumtime të lidhura me këtë tematikë. Angazhimi i kandidatës përfshinë pjesëmarrje dhe prezantim të punimeve shkencore në disa konferenca shkencore ndërkombëtare dhe vëndore, publikime të punimeve në revista shkencore me karakter ndërkombëtar (me faktor ndikimi). Pjesë e arritjeve shkencore, Anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë dhe Senatore, Asistente : Kontabilitet dhe Financa Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis Pejë, Çertifikatë si mbikyrëse dhe organizatore e Konferencës Universiteti i Lisbonës- Protugali , Anëtare e bordit për hulumtim dhe shkencë Bruksel. Anëtare për rishikim të hulumtimeve Web of Science, Scopus.

Fusha shkencore në të cilën do të aplikohen rezultatet:

Buxheti është pasqyrë e bilancit e të gjitha nevojave materiale dhe financiare të bashkësive të gjëra apo të ngushta shoqërore-politike, në të cilën më anë të ligjit planifikohen të hyrat dhe caktohen shpenzimet gjatë një viti.

Buxheti publik përbehet nga katër perspektiva, siç janë:

- ✓ Në aspektin politik- buxheti është një ngjarje politike e kryer për përparësi politike,
- ✓ Në aspektin ekonomik - buxheti parasheh shpërndarjen e burimeve për të mbuluar shpenzimet, ku shpërndarja e burimeve realizohet nga arkëtimi i të hyrave,
- ✓ Në aspektin e kontabilitetit- buxheti parasheh llogaridhënien dhe politikat kontabël për çdo transaksion financiar,
- ✓ Në aspektin e administrimit- buxheti parasheh respektimin e ligjeve gjatë procesit buxhetor

Planifikimi strategjik i buxhetit, është proces kolektiv, transparent dhe me pjesëmarrje, duke përfshirë menaxhmentin e lartë, të punësuarit, konsultimin e gjerë të palëve të interesuara, duke shikuar një imazh më të

gjerë në një perspektivë më afatgjatë. Buxheti publik është plani financiar i shtetit për periudhën një vjeçare. Ai detajohet sipas muajve, dhe zbatimi i tij kontrollohet nga drejtoria e Përgjithshme e Thesarit Buxheti është akt i tre funksioneve kryesore: strategjike, menaxherial dhe operacionale. Funkzioni strategjik- paraqet vendosjen e qëllimeve dhe objektivave të buxhetit shtetëror. Funkzioni menaxherial - paraqet procesin e arritjeve efikase dhe efektive të qëllimeve dhe objektivave të funksionit strategjik, dhe funksioni operacionit- paraqet përqendrimin në ekzekutimin e duhur buxhetit sipas ligjit dhe kontrollit për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave.

Hulumtime të mundshme të ardhshme:

Punimi i disertacionit të Doktoratës i titulluar me titull “Parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik (transparenca dhe përformanca në qeverisje” nga kandidatja MSc. Enkeleda Lulaj, është material i hulumtuar dhe studiuar në mënyrë shumë komplekse të një problematike aktuale të buxhetit në aspektin e transparencës dhe përformancës gjatë qeverisjes.

Ky punim i doktoraturës në të ardhmen duhet të jetë një bazament i fuqishëm për hulumtime të mundshme për një sistem efektiv i MFP-së është thelbësor për zbatimin e politikave publike dhe për të arritur objektivat strategjike kombëtare përmes mbështetjes së disiplinës fiskale agregate, shpërndarjes strategjike të burimeve dhe realizimit efikas të shërbimeve.

Sidomos hulumtime të mundshme në të ardhmen duhet bërë në:

- Vlerësimin e integruar të performancës së MFP-së;
- Transparenca e financave publike;
- Shqyrtimi dhe auditimi i jashtëm;
- Efektiviteti i kuadrit të kontrollit të brendshëm;
- Mjedisi i kontrollit;
- Vlerësimi i Riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informacioni dhe komunikim;
- Monitorimi;

- Pikat e forta dhe pikat e dobëta të MFP-së;
- Disiplina fiskale agregate;
- Shpërndarja strategjike e burimeve;
- Përdorimi efikas i burimeve në funksion të realizimit të shërbimeve;
- Ndryshimet e performancës në krahasim me vlerësimin e fundit;
- Procesi i reformës së MFP-së në qeveri;
- Qasja për reformat e MFP-së;
- Aspekte institucionale.

Përfundim me propozim Këshillit mësimor – shkencor të fakultetit:

Duke i patur parasysh lëndën e hulumtimit, qëllimin e hulumtimit, kontributin shkencor të hulumtimit, pritjen shkencore nga hulumtimi, fushën shkencore të hulumtimit, rezultatet e hulumtimit, kontributet kryesore shkencore të kandidatës, fusha shkencore në të cilën do të aplikohen rezultatet, hulumtime të mundshme në të ardhmen, komisioni konstaton që punimi i disertacionit të doktoraturës të kandidatës **MrSc. Enkeleda Lulaj** me titull “ **Parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik (Transparenca dhe performanca në qeverisje**” i plotëson të gjitha kriteriumet në bazë të nenit 208 të Statutit të Universitetit të Tetovës, nenit 51 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoraturës. Njëkohësisht punimi në fjalë i plotëson kriteret e arsimimit, qasjes aplikative shkencore me të cilat njëherit, plotësohen të gjitha kushtet e një punimi të pavarur hulumtues-shkencor.

Komisioni i propozon Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetit Ekonomik, që të sjellë **VENDIM** për miratim të këtij raporti dhe të vazhdohet procedura për caktim të datës së mbrojtjes së tezës doktoraturës “ **Parametrat e reformimit financiar në buxhetin publik (Transparenca dhe performanca në qeverisje**” të kandidaës **MrSc Enkeleda Lulaj**.

Komisioni:**1. Prof. dr. Etem Iseni – kryetar**

2. Prof. dr. Seadin Xhaferi – anëtar

3. Prof. dr. Merale Fetahi – Vehapi – anëtare


4. Prof. dr. Izet Zeqiri – anëtar

5. Prof. dr. Hamit Aliu – mentor

Qershor 2020

Komisioni:

1. Prof. dr. Etem Iseni – kryetar
2. Prof. dr. Seadin Xhaferi – anëtar
3. Prof. dr. Merale Fetahi – Vehapi – anëtare
4. Prof. dr. Izet Zeqiri – anëtar
5. Prof. dr. Hamit Aliu – mentor



Handwritten signatures of the commission members, corresponding to the list on the left. The signatures are written in blue ink on horizontal lines. The first signature is for Prof. dr. Etem Iseni, the second for Prof. dr. Seadin Xhaferi, the third for Prof. dr. Merale Fetahi, the fourth for Prof. dr. Izet Zeqiri, and the fifth for Prof. dr. Hamit Aliu.

Qershor 2020

